



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AVOKATI I POPULLIT
Seksioni i Administratës



Adresa: Bulevardi: "Zhan D'Ark" Nr.2
Tiranë, Shqipëri

Tel/Fax: +355 4 2380 300/315
E-mail: ap@avokatipopullit.gov.al
www.avokatipopullit.gov.al

Nr. Prot.
Nr. Dok. 201401345/10

Tiranë, ___.___.2014

L ë n d a: *Rekomandohet marrja e masave të menjëhershme për korrigjimin e emrit të shtetases Xh. Y.*

Drejtuar: **ZYRËS SË GJENDJES CIVILE**
Pranë Bashkisë Laç

KURBIN

Për dijeni: **MINISTRISË SË PUNËVE TË BRENDSHME**
Drejtorisë së Përgjithshme të Gjendjes Civile

TIRANË

Pranë Institucionit të Avokatit të Popullit ka paraqitur ankesë shtetasi V. Y., i cili ankohet ndaj Zyrës së Gjendjes Civile, Laç, Kurbin, për zvarritje në korrigjimin e emrit të nënës.

Konkretisht, ankuesi pretendon se Zyra e Gjendjes Civile Laç, Kurbin, në certifikatën e lëshuar, në datë 06.05.2014, emrin i nënës së tij, është shkruar "Xh." në vend të "Xh.", kur në certifikatën familjare të datës 06.03.2012, pasaportën biometrike dhe në kartën e identitetit, emri i shtetases është shkruar saktë "Xh.". Lidhur me këtë pasaktësi, Zoti Y., është drejtuar disa herë pranë Zyrës së Gjendjes Civile Laç, por problemi nuk ka gjetur zgjidhje ligjore.

Sa sipër, ankuesi ka kërkuar edhe ndihmën e Institucionit të Avokatit të Popullit me qëllim ndërmjetësimin pranë jush për trajtimin dhe zgjidhjen e kësaj ankese.

Në përgjigje të kërkesën tonë, me shkresën Tuaj nr. 162/1 Prot., datë 21.07.2014, theksoni se: "... **Shtetasi V. Y. ka mungesë në dokumentacionin e paraqitur ... Kemi kërkuar të plotësojë dokumentacionin e kërkuar si certifikatë nga akti i lindjes dhe certifikatat e trungut familjar. Pasi ... të plotësojë dokumentacionin ..., përgjegjësi i zyrës ... kur është i plotë ja përcjell Drejtorisë së Përgjithshme të Gjendjes Civile ...**".

Ankuesi, sapo ka ardhur në dijeni të përgjigjes të Zyrës së Gjendjes Civile Laç, pretendon se gjithçka që është theksuar në shkresë, është e pavërtetë, pasi ai ju ka vënë në dispozicion dy certifikatat që ju keni kërkuar (certifikatën e lindjes dhe atë të trungut familjar, të znj. Xh. Y.), por zyra e gjendjes civile, pranë Bashkisë Laç, me dashje po zvarrit zgjidhjen e problemit.

Institucioni i Avokatit të Popullit duke e konsideruar ankesën e shtetasis V. Y., të drejtë dhe të bazuar parashtron sa më poshtë:

Bazuar në Udhëzimin nr. 481, datë 05.09.2013, të Ministrit të Punëve të Brendshme, "Për procedurat e korrigjimit të emrit/mbiemrit si gabim material", i interesuari V. Y., ka provuar me dokumente (pasaportë biometrike, kartë identiteti, certifikatë të trungut

familjar), se emri i nënës së tij ka pësuar ndryshime gjatë transkriptimit, pra nga "Xh." në "Xh."

Në nenin 15 të Kodit të Procedurave Administrative është përcaktuar se "*Organet administrative marrin vendime për të gjitha çështjet brenda juridiksionit të tyre të ngritura nga personat privatë në lidhje me çështje që u përkasin drejtpërsëdrejti personave privatë*".

Mosveprimi nga ana juaj për zbatimin e dispozitave ligjore të mësipërme nxjerr si konkluzion një zvarritje dhe mosveprim të dukshëm të zyrës tuaj, fakt që ka sjellë për pasojë shkeljen e të drejtave të ligjshme të këtij shtetasi duke u bërë edhe pengesë për mos kryerjen e veprimeve të mëtejshme procedurale.

Në këtë kuadër, lidhur me mirëfunksionimin e organeve të administratës shtetërore, Avokati i Popullit nisur nga parimi i zbatimit të ligjshmërisë, qëllimi i mirë për përmirësimin e punës, si dhe për një zgjidhje sa më të drejtë dhe ligjore të kësaj ankese e çmon me vend të bëjë këtë rekomandim, duke shpresuar se kështu do të ndihmojmë bashkërisht për vënien në vend të së drejtës së shkelur ndaj shtetasit V. Y..

Për të gjitha këto arsye, në përputhje me nenin 63/3 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, ku përcakton se "*Avokati i Popullit ka të drejtë të bëjë rekomandime*" dhe në mbështetje të nenit 63/3 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, si dhe të nenit 21/b, të Ligjit Nr. 8454, datë 4.02.1999, "*Për Avokatin e Popullit*", në të cilët përkatësisht thuhet se: "*Pas përfundimit të hetimeve, Avokati i Popullit paraqet rekomandime për vënien në vend të së drejtës së shkelur tek organi administrativ që, sipas tij, ka shkaktuar shkelje të të drejtave dhe lirive*",

REKOMANDOJMË:

Marrjen e masave të menjëhershme për korrigjimin e emrit të nënës "Xh.", në certifikatën familjare të ankuesit V. Y., nga Zyra e Gjendjes Civile pranë Bashkisë Laç, Kurbin.

Në përputhje me nenin 22, të Ligjit Nr. 8454, datë 04.02.1999, "Për Avokatin e Popullit", i ndryshuar, lutemi na ktheni përgjigje të argumentuar brenda afatit 30 ditor lidhur me masat ligjore dhe qëndrimin që do të mbani ndaj këtij rekomandimi,

Duke besuar në bashkëpunimin dhe mirëkuptimin tuaj,

K O M I S I O N E R E

Etilda GJONAJ (SALIU)